



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 382, datë 02.10.2020**

**PËR**  
**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË**  
**NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË NË**  
**FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 85, DATË**  
**26.02.2020 DHE PËR DY POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS**  
**PENALE, SHPALLUR ME VENDIMET NR. 242 DHE NR. 244, DATË 09.07.2020, TË**  
**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Alban Toro,

**VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 85 datë 26.02.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 242 dhe nr.244, datë 09.07.2020.
2. Vendimi nr. 212, datë 18.06.2020 dhe Vendimi nr. 349, datë 28.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**